



Canada

Të drejtat pronësore të grave të rrjedha nga trashëgimia

Ky studim është hartuar nga ekspertët e shoqatës “Gruaja tek Gruaja”, në kuadër të projektit “*Vepro! Për të drejtat pronësore dhe trashëgimore të grave. Përmirësimi i aksesit të grave në të drejtat pronësore e trashëgimore përmes rritjes së ndërgjegjësimit, avokimit dhe shërbimeve*”. Ky projekt mbështetet financiarisht nga **Canada Fund for Local Initiatives (CFLI)** dhe zbatohet nga shoqata “Gruaja tek Gruja” Shkodër.

***Disclaimer**

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë studim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Canada Fund for Local Initiatives.



Canada

Tabela e Lëndës

<i>Të drejtat pronësore të grave të rrjedha nga trashëgimia</i>	1
Hyrje	3
Metodologjia e aplikuar	5
1. Përmbledhje e kuadrit ligjor ndërkombëtar	6
1.1 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut	6
1.2 Konventa "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj Grave [CEDAW], ratifikuar me Ligjin Nr. 1769/1993.....	6
1.3 "Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore" ratifikuar me Ligjin Nr. 7511/1991.....	7
1.4 "Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat civile dhe politike", ratifikuar me Ligjin Nr. 7510/1991.....	7
1.5 Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.....	7
1.6 Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian	8
2. Kuadri ligjor kombëtar	8
2.1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë	8
2.2 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë	9
2.3 Dispozitat e Kodit Shqiptar të Familjes që prekin trashëgiminë	12
2.4 Ligji nr. 110/2018 "Për Noterinë"	13
2.5 Ligji nr. 111/2018, "Për kadastrën"	14
2.6 Ligji nr. 10221, datë 4.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" dhe ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"	14
3. Aksesi i grave dhe vajzave në të drejtat pronësore të trashëgimisë nga këndvështrimi i studimeve, raporteve dhe publikimeve	14
Situata në Bashkinë Shkodër	17
Të dhëna nga pyetësorët	17
Të dhëna nga intervistat	24
Përfundime	28
Bibliografia	29



Canada

Hyrje

Prona, në të gjitha format e saj, vlerësohet dhe njihet në të gjitha shoqëritë, si faktori kryesor që ndikon dhe përmirëson statusin socio-ekonomik të një individi.¹

Garantimi i të drejtave pronësore, ka rezultuar të ketë impakt pozitiv në jeten e grave, konkretisht: në rritjen e fuqisë së tyre negociuese brenda familjes, duke u dhënë atyre një ndjenjë sigurie dhe besimi, si dhe në dhënien e një statusi më të lartë për to në shoqëri në përgjithësi. Përveç kësaj, duke garantuar të drejtat pronësore të grave, qëllimi është t'i ofrohet një mjet ekonomik që ato mund ta përdorin për të sfiduar dhunën në familje - një fenomen që ndikon thelbësisht jetët e tyre në mbarë botën. Hulumtimet e fundit kanë sugjeruar se të qënurit pronare e një pasurie të paluajtshme ul rrezikun e dhunës në familje për disa gra, sepse pavarësia ekonomike, që shpesh vjen si rezultat i të qënurit pronare e një pasurie të paluajtshme, do të thotë se ato janë në kushtet për të lënë një marrëdhënie abuzive.

Pavarësisht rolit kyq që ka garantimi i të drejtave pronësore të grave në zhvillimin e tyre ekonomik, historikisht në vendet në zhvillim në përgjithësi rezultojnë të ketë një diskriminim për sa i takon aksesit të grave në këto të drejta. Vitet e fundit shumë shtete janë angazhuar në adresimin e pabarazive të kësaj natyre në legjislacion të cilat në zbatim nuk kanë sjellë rezultatet e pritshme.

Për sa i takon rastit të Shqipërisë, fatkeqësisht me gjithë progresin e bërë ndër vite, shoqëria shqiptare vijon të jetë e karakterizuar si patriarkale, ku meshkujt zakonisht konsiderohen kryefamiljarët dhe kanë rolin e vendimmarrësit dhe kontrolluesit financiar të familjes. Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, (raporti i katërt periodik i Shqipërisë, korrik 2016), në vëzhgimet e tij përmbyllëse theksoi se “vetëm 8% e grave zotërojnë tokë”, dhe përveç kësaj, ato gjithashtu vunë në dukje: se ata shpesh diskriminohen në çështjet e trashëgimisë”.² Sipas një artikulli të dedikuar të drejtave pronësore të grave dhe vajzave të Report.al që daton në vitin 2019, rezultojnë se: “nga të dhënat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të cilat bazohen në digjitalizimin e 43.6 % të të dhënave të kartelës së pasurisë në pronësi publike dhe private në Shqipëri, pronësia mbi pasuritë private të paluajtshme të regjistruara është në raportin 19.1% në emër të grave dhe 80.9% në emër të burrave. “Pronësia mbi pasuritë e paluajtshme private të llojeve truall, tokë bujqësore, pyll dhe kullotë është në raportin 18.5% në emër të grave dhe 81.5% në emër të burrave,” tha ASHK në një përgjigje me shkrim. “Pronësia mbi pasuritë e paluajtshme private të regjistruara të llojit banesë është në raportin 18.7% në emër të grave dhe 81.3% në emër të burrave,”.³

¹ Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë, Qeverisja e tokës për gratë dhe burra. (FAO 2013) Një udhëzues teknik për të mbështetur arritjen e qeverisjes së përgjegjshme të barazisë gjinore të të drejtave mbi token.

² CEDAW (2016), Vëzhgime përmbyllëse mbi raportin e katërt periodik të Shqipërisë, 25 korrik 2016, CEDAW /C/ALB/CO/4.

³ <https://www.reporter.al/2019/08/06/paligjshmeria-dhe-tradita-u-mohojne-te-drejten-e-prones-grave-dhe-vajzave-ne->



Canada

Gjithashtu, sipas disa intervistave të kryera në kuadër të studimit të titulluar “Të drejtat e pronësisë së grave në Shqipëri”,⁴ gjyqtarët dhe ekspertët e intervistuar theksuan se “trashëgimia dhe prona bashkëshortore janë mënyrat kryesore nëpërmjet të cilave gratë fitojnë të drejta pronësore”. *Shifrat e ulta të grave që zotërojnë pasuri të paluajtshme, janë tregues i sfidave me të cilat përballen gratë në aksesin e të drejtave pronësore, por duke qënë se trashëgimia rezulton të jetë mënyra kryesore se si ato i fitojnë këto të drejta, shfaqet si domosdoshmëri hulumtimi i shkaqeve që qëndrojnë pas këtij hendeku dhe adresimi i tyre në mënyre strategjike.*

Pavarësisht se ky fenomen rezulton të jetë jo vetëm kombëtar, mbasi raste të tilla të trajtimit të pabarabartë në çështjet e aksesit në të drejtat e pronësisë e trashëgimisë gjejmë edhe në vende të tjera të botës, punimi kufizohet në një analizë të përgjithshme këtij fenomeni në rang kombëtar duke pasur parasysh dokumentet e marrë në analizim, por me një fokus të veçantë të Bashkisë Shkodër, nisur nga fakti që në këtë Bashki po zbatohet projekti në kuadër të të cilit realizohet ky punim.

[shqiperi/](#)

⁴ UN Women (2016) “Të drejtat pronësore të grave në Shqipëri”, botim i dytë.



Canada

Metodologjia e aplikuar

Ky kapitull përshkruan qasjen metodologjike të këtij studimi, duke parashtruar pyetjet kërkimore, qasjen për mbledhjen e të dhënave dhe aktorët e përfshirë. Ky punim përpiqet të hedh dritë mbi shkaqet që pengojnë gratë dhe vajzat në zonën e Bashkisë Shkodër të aksesojnë të drejtat pronësore që rrjedhin nga trashëgimia pavarësisht ekzistencës së një kuadri ligjor i cili respekton barazinë gjinore.

Kështu ky studim, në përpjekje për ti dhënë përgjigje pyetjes kërkimore, ndërthur hulumtimin e legjislacionit dhe të raporteve, studimeve e dokumentave ekzistuese që adresojnë në mënyrë direkte apo indirekte aksesin në të drejtat pronësore të rrjedha nga trashëgimia të grave dhe vajzave, si dhe të dhënat cilësore e sasiore të rezultuara nga hulumtimi i bërë me të njëjtin qëllim por me fokus të përqëndruar në Bashkinë Shkodër.

Kështu, studimi, së pari përpiqet të sjellë një pasqyrë të përgjithshme të kuadrit ligjor rregullator ndërkombëtar dhe kombëtar për sa i takon pasurisë dhe të drejtave pronësore që rrjedhin si rezultat i trashëgimisë.

Së dyti, tenton të sjellë një përmbledhje të situatës aktuale të aksesit të grave në këto të drejta në nivel kombëtar, parë nga këndvështrimi i raporteve, studimeve dhe publikimeve të bëra që përmbajnë të dhëna relevante lidhur me çështjen në trajtim.

Së treti, analizon të dhënat sasiore e cilësore të rezultuara nga procesi i mbledhjes së të dhënave nëpërmjet pyetësorëve shpërndarë banorëve të Bashkisë Shkodër gra dhe burra, djem dhe vajza nga zonat rurale e urbane të këtij qark si dhe intervistave realizuar me gjyqtarë, noterë, punonjës së kadastrës dhe ekspert jurist, avoketër dhe punonjës të organizatave jofitimprurëse të angazhuara në adresimin e çështjeve që lidhen me të drejtat e grave.



Canada

1. Përmbledhje e kuadrit ligjor ndërkombëtar

1.1 Deklarata Univerale e të Drejtave të Njeriut

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut konsiderohet si një dokument i rëndësishëm së veçantë pikërisht për faktin se në frymën e saj janë ngritur dhe strukturuar të gjithë instrumentat e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në këtë instrument gjejmë dy nene që lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me tematikën e studimit. Konkretisht:

nenin 17 përcakton se *“1. Gjithkush ka të drejtën të ketë pasuri, si vetëm ashtu edhe në bashkëpronësi me të tjerët. 2. Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij”*.

Në nenin 25/1 përcaktohet se: *“Gjithkush ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm që t’i përgjigjet shëndetit dhe jetës së përshtatshme si të atij personalisht, ashtu edhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banesën, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si edhe të drejtën për të qenë i siguruar në rast sëmundjeje, papunësie, pleqërie dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë për shkak të rrethanave të pavarura nga vullneti i tij/saj”*.

1.2 Konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj Grave [CEDAW], ratifikuar me Ligjin Nr. 1769/1993

Konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj Grave, e nënshkruar në vitin 1979 dhe hyrë në fuqi më 1981, është ratifikuar nga Kuvendi i RSH në vitin 1993. Në këtë Konventë sanksionohet mbrojtja nga diskriminimi ndaj grave, nëpërmjet masave të përkohshme të veçanta që synojnë përshtetimin de facto të barazisë midis burrave dhe grave; si dhe masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave me qëllim që t’i sigurohen atyre të drejta të barabarta me burrat në fusha të ndryshme. Në lidhje me kontekstin që trajtojmë, gjejmë një rregullim nga neni 16 pika (ë) nëpërmjet të cilit sanksionohet se *“shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe me marrëdhëniet familjare. Në mënyrë të veçantë ata i sigurojnë gruas mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas: (ë) Të drejtat e njëjta për secilin prej bashkëshortëve lidhur me pronësinë, blerjen, administrimin, gëzimin dhe disponimin e pasurisë, si falas ashtu edhe me pagesë”*.



Canada

Rekomandimi i përgjithshëm 21 i Komitetit CEDAW⁵ për barazi në martesën dhe marrëdhëniet familjare thekson në mënyrë specifike se e drejta për të poseduar, administruar, gëzuar dhe disponuar pronën është në qendër të drejtës së gruas për të gëzuar pavarësinë financiare. Më konkretisht në lidhje me trashëgiminë, Komiteti i CEDAW shprehet se ligji dhe praktika vijon të rezultojë diskriminuese në lidhje me trashëgiminë e pronës nga gratë dhe se ndaj këtyre praktika duhet marrë masa.

1.3 “Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore” ratifikuar me Ligjin Nr. 7511/1991

Referuar Komentit të Përgjithshëm mbi të drejtën për ushqim të përshtatshëm në kuadër të parashikimeve të nenit 11⁶ të Konventës i cili sanksionon njohjen nga shtetet palë të të drejtës së të gjithë personave për një standard jetese të përshtatshëm për veten dhe familjet e tyre, duke përfshirë ushqim adekuat, veshmbathje dhe strehimi, si dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës, Komiteti risjell vëmendjen tek e drejta për trashëgim dhe pronësi mbi tokën si resurse ekonomike të një rëndësie të veçantë.

1.4 “Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat civile dhe politike”, ratifikuar me Ligjin Nr. 7510/1991

Neni 23 (4) kërkon që Shtetet Palë të marrin hapat e duhura për të siguruar barazinë e të drejtave dhe përgjegjësi të bashkëshortëve në lidhjen e martesës, gjatë martesës si dhe në rastin e mbarimit të saj. Edhe në Komentin e Përgjithshëm për sa i takon barazisë së burrave dhe grave Komiteti shprehet se duhen marrë masa konkrete nga Shtetet për përmbushjen e detyrimeve që lidhen me barazinë e bashkëshortëve në çështjet e pronësisë dhe administrimit të saj.

1.5 Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ sanksionon se “çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Neni 1 i Protokollit Nr.1 mbron individët ose personat juridikë nga ndërhyrjet arbitrare të shtetit tek pronat e tyre. Megjithatë, ai njeh të

⁵ Komiteti i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW), Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 21 i CEDAW: Barazia në Marrëdhëniet Martesore dhe Familjare, 1994, i disponueshëm në: <https://www.refworld.org/docid/48abd52c0.html>;

⁶ Komenti i Përgjithshëm Nr. 12 I CESCR “E drejta për ushqim të përshtatshëm” (Neni 11) i disponueshëm në: <https://www.refworld.org/pdfid/4538838c11.pdf>;



Canada

drejtën e shtetit të kontrollojë përdorimin dhe madje të privojë nga prona e individë apo persona juridikë, sipas kushteve të parashikuara në atë dispozitë.

1.6 Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian

Në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian e drejta e pronës rregullohet në nenin 17 sipas të cilit përcaktohet se “gjithkush ka të drejtën për të zotëruar, disponuar e të lërë trashëgim pasurinë e tij apo të saj të fituar ligjërisht. Askush nuk mund të privohet nga pasuria e tij/saj, përveçse në interes publik dhe në rastet dhe sipas kushteve të parashikuara me ligj, në pajtim me një shpërblimi të drejtë duke u paguar në kohën e duhur për humbjen e pësuar.”

2. Kuadri ligjor kombëtar

2.1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është norma supreme e shtetit dhe, mund të themi se ajo promovon vlera demokratike të gjithëpranuara nga vendet evropiane perëndimore dhe demokracitë përparimtare. Në të janë sanksionuar parimet e demokracisë kushtetuese si: shteti i së drejtës, demokracia, pluralizmi, ndarja e pushteteve, të drejtat e njeriut, dinjiteti njerëzor, etj

Në kuadër të të drejtave të njeriut, parimi i barazisë si një bazë Shteti Social, i cili nëpërmjet parashikimit të të drejtave sociale në Kushtetutë bën të mundur garantimin e barazisë thelbësore: të individit në shoqëri, individit në rendin juridik, si dhe grupeve shoqërore që individët krijojnë për realizimin e personalitetit të tyre. Sipas nenit 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë “të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.

Po ashtu pronësia përbën një nga të drejtat themelore, të lindura bashkë me njerëzimin, e cila konsiston në të drejtën e individit për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufinjve të përcaktuar nga ligji. E drejta e pronësisë paraqet një ndër institutet juridike me të rëndësishme të së drejtës civile në përgjithësi dhe gjithashtu përbën formën kryesore të ushtrimit të të drejtave të njeriut mbi sendet. Si të tillë e gjejmë të sanksionuar në Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë në nenin 11 të saj, “si prona private ashtu edhe ajo publike mbrohen njëllë me ligj” dhe konsiderohen si bazë solide për sistemin ekonomik të Shqipërisë. Po në Kushtetutë, neni 41 përcaktohen edhe format e fitimit të pronësisë ndërmjet të cilave gjëndet edhe trashëgimia.



2. 2 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, përfaqëson tërësinë e normave që rregullojnë fitimin e pronësisë, bashkëpronësinë dhe kontratat. Pronësinë dhe trashëgiminë si dy institute themelore të të drejtës civile i gjejmë të rregulluar në dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Sipas nenit 149-të të KC “Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufinjve të caktuar nga ligji”⁷.

Meqënëse studimi ka në fokus të drejtat pronësore të grave në trashëgimi, vlerësohet si e domosdoshme një shprehje paraprak i këtij koncepti për qëllime të këtij studimi.

Mbi pronësinë: kështu sa i takon pronësisë, legjislacioni shqiptar njih dy kategori pronash, private dhe publike referuar Kushtetutes, “*prona private dhe publike përbëjnë themelin e sistemit ekonomik në vendin tonë dhe të dyja ato mbrohen njëllë me ligj*” ku kriteri themelor, edhe pse jo i vetmi, i dallimit të llojeve të pronësisë, është ai në bazë të subjektit pronar, kur subjekti i pronësisë është shteti, prona quhet pronë publike, kur pasuria është e individëve, pasuria në zotërim të tyre quhet pronë private. Kriter tjetër i dallimit është dhe objekti. Objekt i të drejtës së pronësisë janë sendet pa dallim, të luajtshme apo të paluajtshme.⁸

Ndërsa me pasuri trashëgimore kuptohet tërësia e të drejtave pasurore që kalojnë nga trashëgimlënësi tek trashëgimtarët pas vdekjes së tij. Me pasuri kuptohen jo vetëm sendet, por edhe tërësia e të drejtave dhe detyrimeve pasurore të trashëgimlënësit, të cilat u kalojnë trashëgimtarëve të tij. Përcaktimi i saktë i përbërjes së pasurisë trashëgimore ka rëndësi vendimtare në caktimin e pjesëve trashëgimore si dhe në përcaktimin e kufijve të përgjegjësisë së trashëgimtarëve për detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore. Në pasuri nuk përfshihen të drejtat personale jopasurore, të lidhura ngushtë me personin, ato që quhen të drejta “*intuitu personae*”.

Mbi trashëgiminë: trashëgimia nga ana tjetër e cilësuar si një nga mënyrat nëpërmjet të cilës gratë përfitojnë pasuri, është një nga mënyrat derivative fitimi të pronësisë *mortis causa* në ndryshim nga të gjitha mënyrat e tjera të cilat ndodhin *inter vivos*. Sipas nenit 316 po të këtij kod, trashëgimia konsiderohet të jetë “kalimi me ligj ose me testament i pasurisë (trashëgimit) të personit të vdekur, një ose më shumë personave (trashëgimtarë), sipas rregullave të caktuara në këtë Kod”.⁹ Kodi Civil njih dy mënyra të kalimit të trashëgimisë, pas vdekjes së të ndjerit, pasuria kalon nga i vdekuri të trashëgimtarët nëpërmjet çeljes së trashëgimisë me ligj ose me testament.

Trashëgimia me ligj zbatohet në ato raste kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament, ose ka lënë testament vetëm për një pjesë të pasurisë së tij, ose në rastet kur testamenti është

⁷ Neni 149 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;

⁸ Nathanailli A., (1974), E drejta e pronësisë e RPSH-së, kurs leksionesh, Tiranë;

⁹ Neni 316 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;



Canada

shpallur pjesërisht apo tërësisht i pavlefshëm. Personi, pasuria e të cilit pas vdekjes së tij i kalon një ose disa personave, që mund të jenë caktuar me testament ose ligj, quhet trashëgimlënës. Trashëgimtarë janë personat, të cilëve në bazë të ligjit ose me testament, u kalon pasuria e personit të vdekur pas vdekjes së tij. Trashëgimtarë mund të jenë persona fizikë, persona juridikë ose dhe shteti. Trashëgimtarë ligjorë mund të jenë vetëm personat dhe shteti, ndërsa trashëgimtarë me testament mund të jenë personat, shteti dhe personat juridikë.

Dispozitat trashëgimore të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, shfaqin tipare të ngjashme me dispozitat trashëgimore të legjislacioneve të tjera në botë, por për efekt të këtij studimi theksojmë që parimi i barazisë vë në pozita të barabarta jo vetëm burrin dhe gruan, por edhe fëmijët meshkuj dhe femra, të lindur nga martesja dhe të lindurit jashtë saj, kur atësia ose mëmësia është njohur rregullisht, si dhe të birësuarit,¹⁰ pavarësisht se si ky parim manifestohet i zbatuar në realitet.

Kështu në përcaktimin e rradhës së thirrjes së trashëgimtarëve që legjitimohen për të trashëguar, ligji fillimisht merr në konsideratë lidhjet e gjakut dhe birësimin. Sipas nenit 360 të Kodit Civil “trashëgimtarët ligjorë janë fëmijët, fëmijët e fëmijëve, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave të paravdekur, gjyshi e gjyshja e të paralindurit e tjerë, personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, të afërmit e tjerë deri në shkallën e gjashtë, si dhe shteti. Këta thirren në trashëgim sipas rradhës të caktuar në këtë Kod”. Rezultojnë gjashtë shkallë të përcaktuara në nenet 360-367 të Kodit Civil.

Pozita e bashkëshortit pasjetues nga literatura¹¹ është vlerësuar si e favorshme në rastet e trashëgimisë ligjore, duke qënë se sipas dispozitave të Kodit Civil¹² në radhë të parë në trashëgim thirren fëmijët, fëmijët e fëmijëve dhe bashkëshorti duke trashëguar secili në pjesë të barabarta. Kur njëri nga fëmijët ka vdekur, është bërë i padenjë për të trashëguar, ka hequr dorë apo është përjashtuar në vend të tij hyjnë me zëvendësim fëmijët e tij dhe kur për shkaqet e përmendura as këta nuk mund të jenë trashëgimtarë, vijnë në trashëgim të paslindurit pa asnjë kufizim. Në këtë rast zbatohet trashëgimia me zëvendësim dhe pjesa e prindit që nuk trashëgon ndahet në pjesë të barabarta midis të paralindurve që e zëvendësojnë atë. Në rastin kur në radhë të parë nuk ka trashëgimtarë të tjerë, përveç bashkëshortit thirren në trashëgim trashëgimtarë të radhës së dytë dhe kur nuk ka as të tillë ata të radhës së tretë. Në këto raste bashkëshorti trashëgon gjithmonë jo më pak se gjysmën e pasurisë trashëgimore. Kur nuk ka trashëgimtarë nga gradat e mësipërme, trashëgimia i kalon bashkëshortit pasjetues. Pavarësisht se parashikimet ligjore duket sikur e favorizojnë pozitën e bashkëshortit pasjetues në të vërtetë praktika evidenton raste të pengesave që e kufizojnë barazinë në gëzimin e të drejtës së për të trashëguar. I tillë konsiderohet rasti i heqjes dorë nga trashëgimia, si një institut i cili

¹⁰ Neni 360, 361, 362 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;

¹¹ Juliana Latifi (2007), E drejta Civile, Trashëgimia;

¹² Neni 361 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;



Canada

parashikohet në nenin 333 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Ky fenomen sillet në vëmendje edhe nga studimi i realizuar nga Arta Mandro ku theksohet se vajzat dhe gratë shumë shpesh heqin dorë nga të drejtat e tyre trashëgimore që i përkasin sipas ligjit duke u influencuar nga e drejta zakonore sipas të cilës duhet të përfitojnë djemt e shtëpisë në rastin e trashëgimit nga familja e origjinës apo nga familja e bashkëshortit kur çifti nuk ka pasur fëmijë.

Heqja dorë nga trashëgimia. Duke qënë se praktika evidenton shpesh herë raste të heqjes dorë nga trashëgimia nga gratë në favor të djemve të familjes së origjinës apo në favor të trashëgimtarëve të tjerë të radhës të bashkëshortit, shfaqet relevante një shpjegim i këtij instituti në kuptim të dispozitave të Kodit Civil ku sipas nenit 333¹³ heqja dorë nga trashëgimia duhet të bëhet me deklaratë të shkruar, që regjistrohet te noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimia, ose me deklaratë noteriale të redaktuar nga noteri. Heqja dorë nga trashëgimi mund të bëhet brenda 3 muajve nga çelja e trashëgimisë (kupto vdekjen e trashëgimlënësit) dhe kur trashëgimtari është jashtë shtetit, jo më vonë se 6 muaj. Trashëgimtari që ka deklaruar rregullisht heqjen dorë ose jo nga trashëgimi, nuk mund ta shfuqizojë më pas këtë deklaram. Heqja dorë nga trashëgimi, e bërë para çeljes së trashëgimisë, ose kur bëhet me kusht, me afat, ose për një pjesë të trashëgimit, apo në dobi të njërit nga trashëgimtarët e tjerë, është e pavlefshme.

Trashëgimia testamentare në kuptim të nenit 372 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë konsiderohet si “një veprim juridik i njëanshëm i kryer nga vetë trashëgimlënësi, me anë të të cilit ky disponon pasurinë e tij për kohën pas vdekjes”.¹⁴ Njihen dy forma testamentesh sipas këtij Kodi, ollograf dhe me akt noterial¹⁵, ku testamenti ollograf shkruhet tërësisht me dorën e testatorit duke vënë datën dhe nënshkrimin e vet, duhet të përmbajë datën e cila gjithashtu duhet të tregojë ditën, muajin dhe vitin. Në fund të disponimeve duhet të nënshkruhet nga testatori. Ndërsa testamenti me akt noterial redaktohet nga noteri dhe nënshkruhet nga trashëgimlënësi në prani të noterit. Edhe në rastin e testamentit me shkrim, vihet re një favorizim i meshkujve, noterja Elona Saliq në një artikull publikuar nga Report.al shprehet se “më së shumti, të gjithë që vijnë qoftë dhe për të lënë testamentin, duan që ta fokusojnë testamentin e tyre totalisht në emrin e djalit dhe vetëm të meshkujve të familjes”¹⁶. Ky realitet evidentohet edhe në studimin e përgatitur nga Arta Mandro, në të cilin theksohet se “sa i përket trashëgimisë me testament, në praktikën gjyqësore konstatohet se në pjesën më të madhe të rasteve, kur trashëgimlënësi e ka disponuar vullnetin e tij me testament, disponon në favor të trashëgimtarëve burra e djem. Gratë dhe vajzat ose janë përjashtuar nga

¹³ Neni 333 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;

¹⁴ Neni 372 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;

¹⁵ Neni 392 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;

¹⁶ Artikull publikuar në Report.Al “Paligjshmëria dhe tradita u mohojnë të drejtën e pronës grave dhe vajzave në Shqipëri” e disponueshme në: <https://www.reporter.al/2019/08/06/paligjshmeria-dhe-tradita-u-mohojne-te-drejte-e-prones-grave-dhe-vajzave-ne-shqiperi/>;



Canada

trashëgimia ose kur janë caktuar si trashëgimtare testamentare, kanë për pjesë atë më të vogël të pasurisë trashëgimore”.¹⁷

2.3 Dispozitat e Kodit Shqiptar të Familjes që prekin trashëgiminë

Çështjet pasurore kanë rëndësi të veçantë në rast të përfundimit të martesave si pasojë e vdekjes së njërit prej bashkëshortëve. Të drejtat trashëgimore në lidhje me pasurinë e bashkëshortëve kanë implikime shumë të ndryshme në varësi të faktit nëse martesa ka përfunduar për shkak të vdekjes apo për shkak të një divorci.¹⁸ Duke pasur parasysh se ky studim fokusohet kryesisht në të drejtat e trashëgimisë, në fokus të tij do të jenë vetëm pasojat e përfundimit të martesës për shkak të vdekjes dhe implikimet që kjo ka për sa i përket të drejtave pronësore të trashëgimisë.

Vdekja e njërit prej bashkëshortëve sjell automatikisht zbatimin e të drejtave të trashëgimisë.¹⁹ Në këtë pikë është tejet e rëndësishme të njohim dhe të kuptojmë drejtë dispozitat e Kodit të Familjes së Republikës së Shqipërisë që lidhen me regjimet pasurore martesore për të kuptuar më pas pasojat, në aspektin e trashëgimisë si një mënyrë për të fituar pasuri, si pasojë e vdekjes së njërit prej bashkëshortëve.

Në fillim, është e rëndësishme të theksohet se Kodi i Familjes së Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të ngjashme me Kodin Civil, është shkruar i udhëhequr nga parimi i barazisë midis grave dhe burrave.²⁰ Sipas dispozitave të Kodit Civil në lidhje me trashëgiminë, bashkëshorti pasjetues është në rreshtin e parë të trashëgimtarëve ligjor dhe mund të trashëgojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme që i përkasin trashëgimlënësit. Ky Kod, parashikon një grup gjithëpërfshirës rregullash që i dedikohen posaçërisht të drejtave pronësore për bashkëshortët, të cilët pas vdekjes së bashkëshortit tjetër i nënshtrohen rregullave të të drejtave të trashëgimisë, mortis causa, në lidhje me ndarjen e pasurisë.

Regjimet pasurore martesore gjejnë rregullim në Kodin e Familjes së Republikës së Shqipërisë dhe me regjim pasuror martesor në kuptim të të drejtës familjare duhet të kuptojmë tërësinë e normave dhe rregullave juridike që përcaktojnë mënyrën e gëzimit, administrimit dhe disponimit të pasurisë bashkëshortore. Të drejtat, detyrimet dhe tagrat që kanë bashkëshortët kundrejt pasurive vetjake apo të bashkësisë sipas llojit të regjimit. Dy janë regjimet kryesore pasurore: regjimi me ligj dhe regjimi me kontratë. Në regjimin me ligj, siç është ai i bashkësisë ligjore, janë dispozitat e Kodit të Familjes që përcaktojnë se cila pasuri, e ardhur, etj do të jetë e bashkësisë dhe cila vetjake. Regjimi me kontratë mund të shfaqet në formën e bashkësisë me kontratë ose në formën e regjimit të pasurive të ndara. Dallimi midis këtyre dy regjimeve qëndron në autonominë e bashkëshortëve për të vetëvendosur mbi

¹⁷ UN Women (2016) “Të drejtat pronësore të grave në Shqipëri”, botim i dytë.

¹⁸ Arta Mandro, E drejta Familjare – Familja, Femijët, Martesa, Bashkëshortët, (Emal 2009);

¹⁹ Neni 318 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, 1994;

²⁰ Arta Mandro, E drejta Familjare – Familja, Femijët, Martesa, Bashkëshortët, (Emal 2009);



Canada

rregullat që rregullojnë çështjet e tyre pronësore. Këto dispozita marrin një rëndësi akoma më të veçantë kur bëhet fjalë për çeljen e trashëgimisë dhe përcaktimin e pjesës së pasurisë që do t'i nënshtrohet ndarjes. Një çift nën regjimin e pasurive të përbashkëta i disponon asetet pronë e tyre me të drejta të barabarta mes njeri-tjetrit, ndaj objekt i trashëgimisë në rastet kur ndërron jetë bashkëshorti është gjysma e pasurisë. Noteri ka detyrim ligjor që në dëshmi të citojë klauzolën se *dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrethit të trashëgimtarëve në çastin e regjistrimit pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, nuk mund të cenojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përftuara përgjatë martesës*. Ka raste kur bashkëshortja heq dorë nga trashëgimia, nga pjesa që i takon si trashëgimtare dhe në momentin që prona regjistrohet pranë kadastrës ajo fshihet fare si bashkëpronare e pasurisë së paluajtshme.

2.4 Ligji nr. 110/2018 “Për Noterinë”

Ligji²¹ për noterinë ka një rëndësi të madhe për sa i takon kuadrin ligjor që afekton të drejtat pronësore të grave për shkak se gjatë tjetërsimit, fitimit dhe heqjes dorë nga pasuria e paluajtshme nga ana e grave, noterët luajnë një rol kyq në mbrojtjen e këtyre të drejta.

Në kuadër të përmirësimit të kuarit ligjor për mbrojtjen e të drejtave pronësore të grave qeveria ka ndërmarrë iniciativën ligjore të ndryshimit të ligjit për noterinë. Këto ndryshime kishin në fokus garantimin e parimit të barazisë gjinore dhe mbrojtjen e grave nga diskriminimi për shkak të gjinisë. Konkretisht ligji parashikon se aktet noteriale që përmbajnë kalimin e pasurive të paluajtshme, duhet të përmbajnë detyrimisht edhe deklarin e regjimit pasuror martesor, duke cilësuar shprehimisht prezumimin e bashkëpronësisë ligjore, në rastet kur pasuria është e fituar përgjatë martesës dhe kur bashkëshortët nuk kanë përcaktuar me kontratë regjimin e pasurive të ndara. Po kështu, neni 112 i ligjit parashikon detyrimin e noterit për të parashikuar në aktin e lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë të klauzolës se dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrethit të trashëgimtarëve në çastin e regjistrimit pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, nuk mund të cenojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përftuara përgjatë martesës. Neni 127 i cili parashikon procedurat për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme nën regjimin pasuror martesor sanksionon se, në rastet e tjetërsimit ose njohjes së pronësisë mbi sendet e paluajtshme ose të drejtave reale mbi to për personat fizikë, noteri i bashkëngjit aktin përkatës noterial certifikatën familjare dhe/ose martesore të palës blerëse. Noteri bën përshkrimin përkatës në kontratë, duke cituar si blerës/bashkëpronar bashkëshorten/in jo prezent, ipso jure, për shkak të fitimit të të drejtave të pronësisë përgjatë martesës, në përputhje me parashikimet e Kodit të Familjes. Me rëndësi për t'u përmendur rezulton edhe detyrimi i noterit, që në rastet kur konstaton se pasuria e paluajtshme e përftuar përgjatë martesës, për të cilën kërkohet të kryhet akti noterial për tjetërsimin ose njohjen e pronësisë mbi sendet e paluajtshme, ose të drejtave reale mbi to, figuron e regjistruar vetëm në emrin e njërit prej bashkëshortëve dhe bashkëshorti i prezumuar bashkëpronar ka ndërruar jetë, kërkon lëshimin

²¹ Ligji nr. 110/2018 “Për Noterinë”



e dëshmisë së trashëgimisë për bashkëshortin e prezumuar bashkëpronar, si dhe regjistrimin e trashëgimtarëve në certifikatën e pronësisë së pasurisë për të cilën kërkohet të kryhet tjetërsimi ose njohja e pronësisë.

2.5 Ligji nr. 111/2018, “Për kadastrën”

Gjithashtu ligji për kadastrën paraqet një rëndësi të veçantë për sa i takon të drejtave pronësore të grave për shkak të parashikimeve që ai mban dhe procedurave për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të cilat afektojnë në mënyre direkte të drejtat pronësore të grave dhe vajzave. Qeveria gjithashtu ndërhyr me iniciative ligjore në këtë ligj duke përfshirë edhe dispozita të cilat mbrojnë të drejtat pronësore të grave. Konkretisht është parashikimi ligjor në nenin 45 që sanksionon regjistrimin në emër të të dy bashkëshortëve të pronës të blerë gjatë martesës, kur subjektet i nënshtrohen regjimit të bashkësisë ligjore. Ky parashikim eviton praktikën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në emër të kryefamiljarit dhe kufizon rastet e shumta në praktikë të transferimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme familjare nga kryefamiljari, i cili në praktikë nuk merr ose nuk e konsideron të arsyeshme marrjen e pëlqimit të bashkëshortes.

2.6 Ligji nr. 10221, datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”

Parimi i jodiskriminimit dhe i barazisë gjinore garantohet nga këto dy ligje, ku ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” e përkufizon “barazinë gjinore” si “pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe e meshkujve në të gjitha fushat e jetës, pozita e barabartë ndërmjet tyre, mundësi e shanse të barabarta, për të gëzuar të drejtat dhe për të përmbushur detyrimet në shoqëri, duke përfituar njëllor nga arritjet e zhvillimit të saj.” Ndërkohë ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” konsideron dy lloje diskriminimesh ku diskriminim i drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë përkufizohet si trajtimi më pak i favorshëm i një personi për shkak të gjinisë, kur krahasohet me trajtimin që i bëhet, i është bërë ose do t’i bëhej një personi të gjinisë tjetër në një situatë të ngjashme ndërsa konsideron diskriminimin e tërthortë: “hartimi, zbatimi, nxitja dhe krijimi i dispozitave, kushteve, kriterëve apo praktikave, në dukje neutrale, por që sjellin vendosjen në një situatë më pak të favorshme të një personi të njëtrës gjini, krahasuar me personat e gjinisë tjetër”²².

3. Aksesit i grave dhe vajzave në të drejtat pronësore të trashëgimisë nga këndvështrimi i studimeve, raporteve dhe publikimeve

Nga sa mund të vihet re nga shtjellimi i disa aspekteve kryesore të rregullimeve ligjore që legjislatori shqiptar i ka bërë ndër vite çështjeve të trashëgimisë rezultojnë të jetë i bazuar mbi parimin e barazisë ndërmjet burrit dhe gruas si edhe mbi parimin e mos diskriminimit.

²² Ligji nr. 10221, datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” neni 6, paragrafi 1, dhe neni 6, paragrafi 2



Canada

Sidoqoftë shpesh fryma mbi të cilën shkruhet një ligj nuk korrespondon me efektet që ai prodhon në realitet, kjo ndodh për një seri shkaqesh të cilat kanë qënë objekt studimi nga studiues, ekspertë të së drejtës, orgnizata që kanë në fokus të punës së tyre të drejtat dhe liritë themelore të njeriut etj.

Kështu diskriminimi i grave dhe vajzave në çështjet e pronësisë në përgjithësi dhe pronësisë së rrjedhë nga trashëgimia ka qënë një problematikë e cila është adresuar vazhdimisht nga mekanizma ndërkombëtar të monitorimit të të drejtave të njeriut, organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare, studiuesve dhe profesionistëve të së drejtës.

Në vërejtjet për raportin e katërt periodik të Shqipërisë për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave²³ Komiteti në lidhje me përfitimet ekonomike dhe sociale dhe fuqizimin ekonomik të grave, sjell në vëmendje shqetësimin për sa i takon: zbatimin jo të duhur të praktikës së Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit e Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) përmes së cilës prona informale regjistrohet në emër të të ashtëquajturit kryefamiljar, gjë që në praktikë, diskriminon gratë. Në këtë kuadër Komiteti rekomandon që pala shtetërore duhet të marrë masa për përshejtimin dhe lehtësimin e procedurave për legalizimin e ndërtimeve informale dhe të unifikojë praktikatat e ALUIZNI-t në mënyrë që dosjet e aplikimit të përgatiten mbi bazën e certifikatave familjare, dhe jo të diskriminohen gratë duke regjistruar pronën informale nën emrin e të ashtuquajturit kryefamiljar. Ky fakt evidentohet edhe në fjalën e Ministres së Drejtësisë në Konferencën mbi të drejtat e grave²⁴ ku thekson se problematikë e trashëguar ka qënë gjithashtu mungesa e regjistrimit të pasurisë në emër të të dy bashkëshortëve. Praktikisht, nëse një grua aplikonte ose bashkëshorti aplikonte në emër të saj në zyrat e ALUIZNI-t për të legalizuar banesën që ata e kishin pasur së bashku në regjimin e përbashkët pasuror dhe nëse kishte ndodhur një divorc apo më keq një divorc për shkak të dhunës në familje, në rastet kur kjo pasuri duhet të ishte regjistruar në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ajo regjistrohej automatikisht vetëm në emër të bashkëshortit dhe gruaja automatikisht mbetej pa pasuri.

Regjistrimi i pronës në emër të të dy bashkëshortëve vijon të mbetet një sfidë e cila është adresuar edhe nga **Raporti Alternativ mbi Zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri**²⁵ të përgatitur nga Avokati i Popullit, në të cilin theksohet fakti që ndryshimet ligjore përkatëse marrin parasysh parimin e barazisë ndërmjet burrit dhe gruas e megjithatë problematike sipas këtij raport mbetet rritja e kapaciteteve të profesionistëve të së drejtës të ngarkuar me zbatimin e këtyre ligjeve si edhe ndërgjegjësimi i grave dhe vajzave. Regjistrimi i pronësisë në emrin e bashkëshortit jo vetëm që i mohon grave tagrat e pronarit mbi një pasuri që i takon në bazë të ligjit por sjell pasoja edhe në trashëgimi, në këto raste, kur çelet trashëgimia ligjore, pasuria e prezumuar e bashkëshortes nuk llogaritet në ndarjen e pronës me trashëgim dhe kjo e pengon atë të gëzojë pjesën e saj të pasurisë, e cila përfundon e ndarë në pjesë edhe në trashëgimtarët

²³ <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N16/233/02/PDF/N1623302.pdf?OpenElement>

²⁴ Shihni MD, fjala e Ministres së Drejtësisë në Konferencën mbi të drejtat e grave

<http://www.drejtësia.gov.al/neesroom/lajme/ministrja-gjonaj-bashke-per-te-drejtat-e-grave-dhe-kunder-dhunes/>

²⁵ Avokati i Popullit (2016-2020) Raporti Alternativ mbi Zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri



Canada

e tjerë. Pikërisht nisur nga këto pasoja, regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve është adresuar edhe me rregullime ligjore, dhe konkretisht, ligji nr. 111/2018²⁶ parashikon se aktet noteriale që përmbajnë kalimin e pasurive të paluajtshme, duhet të përmbajnë detyrimisht edhe deklarin e regjimit pasuror martesor, duke cilësuar shprehimisht prezumimin e bashkëpronësisë ligjore, në rastet kur pasuria është e fituar përgjatë martesës dhe kur bashkëshortët nuk kanë përcaktuar me kontratë regjimin e pasurive të ndara. Po kështu, ky ligj parashikon detyrimin e noterit për të parashikuar në aktin e lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë të klauzolës së dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrethit të trashëgimtarëve në çastin e regjistrimit pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, nuk mund të cenojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës. Të njëjtat të drejta të mësipërme, ligji parashikon edhe për regjistrimin e pasurive të legalizuara, si dhe për regjistrimin e kontratës së sipërmarrjes, porosisë e të premtimit për shitje, kur këto të fundit synojnë kalimin e pronësisë së objektit në ndërtim, në të ardhmen. Nga të dhënat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të bëra publikë nga **Report.al në vitin 2019 në artikullin me titull “Paligjshmëria dhe tradita u mohojnë të drejtën e pronës grave dhe vajzave në Shqipëri”**, vihet re se pronësia mbi pasuritë private të paluajtshme të regjistruara është në raportin 19.1% në emër të grave dhe 80.9% në emër të burrave. Shifra të cilat tregojnë edhe një herë qartazi pabarazinë ndërmjet burrit dhe gruas për sa i takon pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme.

Në studimin e Arta Mandros “Të drejtat pronësore të grave në Shqipëri”²⁷ trajtohen një gamë shumë e madhe e problematikave dhe veshtirësive që hasin gratë dhe vajzat në çështjet e trashëgimisë parë nga këndvështrimi historik dhe ligjor. Edhe në këtë studim e gjejmë të evidentuar si problematikë faktin se nga ana e të zyrave të kadastrës si edhe nga ana e noterëve, jo në çdo rast merret në konsideratë pasqyrimi i të drejtave të bashkëshortes si bashkëpronare në pasurinë e krijuar gjatë martesës dhe kjo mandej ka ndikuar në përcaktimin e padrejtë të pjesëve të trashëgimtarëve të tjerë në cenim të drejtave të bashkëshortes. Në këtë studim gjejmë të trajtuar si problematikë edhe influencat e të drejtës zakonore në trashëgim, dhe fenomeni i lënies së vajzave e grave jashtë trashëgimit dhe i heqjes dorë nga trashëgimia. Këto fenomene manifestohen në praktika të ndryshme të tilla si, rasti kur çifti jeton me familjen e bashkëshortit, siç është ende zakon i fortë në disa zona të vendit, pasuritë e fituara gjatë martesës regjistrohen në emër të prindërve të bashkëshortit. Me vdekjen e bashkëshortit gruaja e ka të vështirë të provojë kontributin e saj lidhur me përkatësinë e pasurisë. Rast shqetësues nga praktika rezulton gjithashtu kur bashkëshorti vdes dhe çifti nuk ka fëmijë, për “hir” të së drejtës zakonore, bashkëshortja e ve shpesh heq dorë nga të drejtat trashëgimore që i përkasin sipas ligjit. Heqja dorë nga trashëgimia rezulton një praktikë e cila ndodh jo vetëm në familjen e bashkëshortit por edhe në familjen e origjinës të udhëhequra nga “parimet zakonore” se trashëgimia e prindërve iu takon vetëm fëmijëve djem dhe jo atyre

²⁶ Ligji nr. 111/2018 “Për kadastrën”

²⁷ UN Women (2016) “Të drejtat pronësore të grave në Shqipëri”, botim i dytë.



Canada

vajza. Në lidhje me trashëgiminë testamentare, studimi sjell raste të praktikës gjyqësorë ku konstatohet se trashëgimlënësi në pjesën më të madhë të rasteve e ka disponuar pasurinë e tij në favor të trashëgimtarëve djem dhe burra. Gratë dhe vajzat ose janë përjashtuar ose i është caktuar për trashëgim pjesa më e vogël.

Situata në Bashkinë Shkodër

Nisur nga situata e përshkruar më sipër, ku njihemi me pengesat që hasin gratë dhe vajzat në fitimin, gëzimin dhe disponimin e pronësisë së ardhur si rezultat i trashëgimisë në kontekstin shqiptar, përqëndrohemi në një kontekst më të vogël siç është ai i Bashkisë Shkodër në të cilin kemi realizuar një proces hulumtimi për të mbledhë të dhëna lidhur me aksesin që kanë gratë dhe vajzat në të drejtat e pronësisë të rrjedha nga trashëgimia. Të dhënat sasiore janë mbledhur nëpërmjet pyetësorëve shpërndarë banorëve të Bashkisë Shkodër gra dhe burra, djem dhe vajza nga zonat rurale e urbane të kësaj Bashkie. Të dhënat cilësore janë mbledhur nëpërmjet intervistave realizuar me gjyqtarë, noterë, punonjës së zyrës kadastrës, avokatër dhe punonjës të organizatave jofitimprurëse të angazhuara në adresimin e çështjeve që lidhen me të drejtat e grave.

Të dhëna nga pyetësorët

Bloku i parë i pyetjeve të pyetësorit synon të krijojë një profil të statusit social ekonomik të të anketuarve ndërsa blloku i dytë synon të hulumtojë ndër shkaqet që pengojnë gratë dhe vajzat e kësaj bashkie të disponojnë, posedojnë e gëzojnë pasuri që vjen si rezultat i trashëgimisë.

Hulumtimi në terren është zhvilluar me 244 të anketuar në tërë territorin e Bashkisë Shkodër në periudhën shtator-nëntor. Hulumtimi është bërë sipas metodës së rastit.


Anketimit i janë përgjigjur rreth 181 gra dhe vajza dhe rreth 56 burra dhe djem ku 88% e tyre rezultojnë të jenë nga Bashkia Shkodër dhe rreth 17.98% nga njësitë administrative të kësaj Bashkie. Në përgjithësi të anketuarit rezultojnë të jenë të arsimuar ku 21.31% kanë arsim 8-9 vjecar, 26.64% arsim të mesëm, 9.02% profesional, 30.33% arsim të lartë dhe 9.02% me titull master ose doktoraturë. Për sa i takon statusit civil vlen të përmendet që 54.32% janë të martuar ndërsa 35.25% të pamartuar, një përqindje e pakonsiderueshme ndahet ndërmjet i/e divorcuar, i/e ve dhe bashkejtues/e.

Të anketuarit rezultojnë të gjithë shqiptarë dhe vetëm një me përkatësi malazeze. Pyetjes lidhur me sigurinë ekonomike, konkretisht në sa konsistojnë të ardhurat e tyre mujore, i janë shmangur 28 të anketuar ndërkohë që pjesa tjetër kanë dhënë përgjigje të ndryshme duke përmendur shifra të ndryshme të cilat variojnë nga 5000 lek të reja deri në 3000 euro. Këtu vlen të përmendet që shifrat e të ardhurave më të ulta rezultojnë nga gratë dhe vajzat. Për të kuptuar diçka më shumë për sa i takon pushtetit ekonomik brënda strukturës familjare duke qënë të vetëdijshëm për rëndësinë që ka ky pushtet për pozicionimin e gruas brenda familjes,



Canada


kemi shtruar pyetjen kush kontribuon në të ardhurat e familjes.



Referuar edhe grafikut të mësipërm vërejmë se pjesa më e madhe është përgjigjur që në familje kontribuon çdo anëtarë që është në marrëdhënie pune (42.15%), një pjesë tjetër e konsiderueshme përgjigjet edhe bashkëshorti edhe bashkëshortja (21.90%), ndërsa një diferencë vërejmë tek përgjigjet për bashkëshortin dhe bashkëshorten veç. Konkretisht, rreth 14.88% të anketuar janë përgjigjur që në ardhurat e familjes kontribuojnë vetëm bashkëshortët dhe rreth 5.79% janë përgjigjur që në të ardhurat e familjes kontribuojnë vetëm bashkëshortet. **Sipas shifrave të mësipërme vërejmë një pjesëmarrje të konsiderueshme të grave në dhënien e kontributit në të ardhurat e familjes.** Një kontribut i cili shpesh herë vihet në diskutim ose nuk konsiderohet fare sidomos në çështjet e trashëgimisë. Të pyetur nëse të ardhurat e tyre mujore janë fikse apo jo, në përgjigje vërejmë një pasiguri të lartë qoftë për burrat edhe për gratë duke qënë se 40.33% janë shprehur se nuk i kanë të ardhurat fikse. Duke qënë se pjesa më e madhe e të anketuarve janë femra rreth ndër 180 të anketuarve femra që e kanë plotësuar këtë pyetësor 76 prej tyre janë shprehur se të ardhurat e tyre janë jo fikse duke rikonfirmuar **pasigurinë financiare në të cilin jetojnë pjesa më e madhe e grave dhe vajzave në zonën e Bashkisë Shkodër.**



Canada



Nga përgjigjet e dhëna në lidhje me pyetjen se si ato do ta konsideronin statusin social të familjes së tyre pjesa më e madhe përgjigjen se e kategorizojnë veten si një familje me mirëqenie standarde 74.18%.

Rezulton se 69.71% e grave i administrojnë vetë të ardhurat e tyre ndërkohë rreth 28.57% shprehen se një anëtarë i familjes i administron ato për mua ndërkohë që 1.71% shprehen se një person i tretë i administron të ardhurat e tyre. Pavarësisht se pjesa më e madhe e tyre rezulton të jetë e pavarur në administrimin të ardhurave të tyre mujore, shifra 28.57% vijon të jetë një shifër shqetësuese e cila demonstroi kushtet e varësisë në të cilat jo rrallë herë gjenden gratë dhe vajzat e kësaj Bashkie.


Punësimi është një tregues i rëndësishëm i stabilitetit ekonomik dhe ka një rëndësi relevante kur bëhet fjalë për të krijuar një profil social-ekonomik të të anketuarve nga të cilët gjenerojnë këto të dhëna. Nisur nga kjo perspektivë, gjykojmë si të rëndësishëm përfshirjen në pyetësor të pyetjes lidhur me punësimin. Nga analizimi i të dhënave rezulton se kemi një përqindje prej 30% që nuk janë të punësuar dhe një përqindje rreth 70% që rezultojnë të punësuar në sektor privat, publik dhe të vetëpunësuar, kryesisht në sektorin e shërbimeve dhe pjesa më e madhe shprehet se janë mbi baza kontratash me afat të përcaktuar ose të pa përcaktuar. Vlen të theksohet se nga 244 të anketuar rreth 126 rezultojnë gra dhe vajza të cilat rezultojnë të punësuar, pra më shumë se gjysma. **Një tjetër tregues i cili demonstroi se gratë dhe vajzat janë kontribuese në familje dhe në të ardhurat e familjes.** Ndërkohë që pjesa e papunësuar e pyetur nëse ka bërë përpjekje për të gjetur punë, një pjesë e konsiderueshme përgjigjet se janë në moshë pensioni, një pjesë tjetër se janë studente, një pjesë se i janë dedikuar rritjes së fëmijëve.

Blloku i dytë i pyetjeve të pyetësorit synon të nxjerrë të dhëna mbi informacionin, nivelin e ndërgjegjësimit, dhe çfarë perceptimit kanë qytetarët e kësaj Bashkie për gratë dhe vajza si trashëgimtare të të drejtave pronësore të rrjedha nga trashëgimia.

Pyetësori fillon me pyetjen a keni informacion mbi të drejtat trashëgimore pronësore, rreth 72.02% janë përgjigjur se kanë informacion ndërsa 27.98 janë përgjigjur se nuk kanë.




Canada



Gjithashtu, rezulton se të anketuarit janë në dijeni të faktit se gratë dhe vajzat gëzojnë të drejta të barabarta trashëgimore si burrat dhe djemt 85.60% janë shprehur se kanë dijeni.

Interesant dhe me rëndësi për t'u përmendur rezulton fakti se sipas perceptimit të shumicës në masën 82.79% djemt dhe burrat trashëgojnë më shpesh në Shqipëri sesa gratë dhe vajzat. Ndërsa kanë bindjen se pasurinë e prindërve duhet ta trashëgojnë edhe bijat edhe të birt e familjes 75% e të anketuarve kemi një përqindje të vogël por të konsiderueshme 17.36% të cilët besojnë së në fakt duhet të trashëgojnë vetëm të birt.



Pyetjes nëse ato vetë kanë qënë trashëgimtarë të një pasurie të paluajtshme nga prindërit, u përgjigjen jo në masën thuajse 80% po thuajse 20% ndërsa 5 të anketuar i janë shmangur pyetjes. Këtë të dhënë dëshirojmë ta shikojmë edhe nga këndvështrimi gjinor, rezulton se kësaj pyetje i janë përgjigjur po 35 gra dhe vajza ndërsa 141 janë përgjigjur se nuk kanë trashëguar pasuri të paluajtshme nga prindërit. Në pyetjen pasardhëse anketuesit nxiten nëpërmjet një pyetjeje të strukturuar të tregojnë mbi arsyet që i përshtaten më shumë realitetit



Canada

për të cilin ato nuk trashëgojnë. Dhe pjesa më e madhe e tyre në fakt përgjigjen që nuk kanë trashëguar nga familja e prindërve sepse prindërit janë akoma gjallë, ndërsa ka një përqindje domethënëse e cila ndahet ndërmjet përgjigjjes se “trashëgimia pas vdekjes së prindërve i takon vëllezërve dhe vëllait” 14.29%, “ia kam dhuruar vëllait” 2% dhe “kam hequr dorë nga trashëgimia” thaujse 9%. Të dhëna të cilat dëshmojnë se **edhe në Bashkinë Shkodër si ndodh rëndom edhe në bashkitë e tjera të Shqipërisë, mendësija se trashëgimia pas vdekjes u takon vëllezërve si edhe heqja dorë nga trashëgimia janë dy fenomene të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në aksesimin e grave dhe vajzave të të drejtave pronësore që rrjedhin nga trashëgimia.**

Duke qënë se nga praktika rezulton se gratë dhe vajzat mënjanohej edhe nga trashëgimia që rrjedh nga ana e bashkëshortit, si pasojë e vdekjes së bashkëshortit, në pyetësor kemi përfshirë edhe pyetjen “a keni trashëguar pasuri të paluajtshme nga bashkëshorti”, pjesa më e madhe u përgjigj jo sepse bashkëshorti është ende gjallë, ndërkohë pjesa tjetër ndahet ndërmjet dhurimit të fëmijëve, dhurimit të familjarëve të tij, heqjes dorë nga trashëgimia, dhe një pjese e madhe kanë zgjedhur opsionin tjetër, duke shmangur të gjitha alternativat e shtruara si opsionet më frekvente.

Për të kuptuar më shumë në lidhje me mendësinë e tyre për sa i takon grave dhe vajzave dhe çështjeve të trashëgimisë, kemi ngritur pyetjen “a duhet gratë ti kërkojnë të drejtat e tyre të trashëgimisë pronësore tek familja e origjinës”, 75% shprehen se po duhet të kërkojnë ndërkohë që 4% preferojnë të mos përgjigjen ndërsa 20% shprehen për jo. Ato që janë shprehur jo kanë argumentuar më poshtë edhe arsyet pse, dhe më shpesh në përgjigje gjejmë argumentime të tilla si “jo sepse gratë martohen dhe pasuria e familjes së origjinës i takon djemve të familjes”, “sepse nuk ju takon vajzave”, “djali si trashëgimtar i mbiemrit siguron edhe vazhdimsinë e emrit të familjes i takon atij”, “se vajza ka marrë pajë kur është martuar”, “sepse prona i takon vëllezërve ndërsa prona ime është tek bashkëshorti”, “trashëgimia i takon djalit i takon vëllezërve” “nëse trulli lëshohet për një pallat jam dakord që të kenë pjesë të gjithë fëmijët, ndërsa po të jetë një banesë me e vogël e merr djali”, “gruaja ka pjesën e trashëgimisë tek i shoqi”.

Nga këto 39 persona që kanë bërë komente në lidhje me arsyet pse nuk duhet të kërkojnë pjesë rreth 25 janë gra dhe vajza. **Kjo do të thotë që bindja që gratë dhe vajzat nuk duhet të kërkojnë pjesë tek familja e origjinës ndodhet edhe tek gratë dhe vajzat vetë dhe jo vetem tek burrat dhe djemt.**


Të njëjtën pyetje e kemi ngritur edhe në lidhje me pasurinë nga ana e bashkëshortit, nëse duhet gratë dhe vajzat ti kërkojnë të drejtat e trashëgimisë nga ana e bashkëshortit. Të dhënat në këtë rast janë shumë të qarta dhe nuk lënë shumë hapsirë për interpretim. Vihet re një përshtypje e përgjithshme e cila manifestohet në masën 85.60% të të anketuarve të cilët kanë konfirmuar se sipas mendimit të tyre grave dhe vajzave u takon dhe duhet të kërkojnë trashëgimi nga ana e bashkëshortit. Rreth 9.88% kanë zgjedhur ti shmangen përgjigjes duke



Canada

zgjedhur opsionin “preferoj të mos përgjigjem”, ndërkohë që kemi edhe një 4.53% të cilët besojnë se gratë dhe vajzat nuk duhet të kërkojnë trashëgimi nga ana e bashkëshortit dhe në përgjithësi komentet janë të tilla si “i takon fëmijëve”, “u takon djemve të shtëpisë”, “ka të tjerë më të mëdhenj që duhet të përgjigjen për këtë trashëgimi”.

Duke qënë se heqja dorë nga trashëgimia është një ndër format se si gratë dhe vajzat shmangen nga trashëgimia kemi ngritur pyetjen “nëse një anëtar i familjes do ju kërkonte të hiqnit dorë nga të drejtat tuaja të trashëgimisë a do të ishit të gatshëm ta bënit”. Këtë pyetje e kemi analizuar nga këndvështrimi gjinor mbasi jemi kryesisht të interesuar për rezultatin që gjenerohet nga të dhënat e grave dhe vajzave.



Siç mund të vihet re lehtësisht edhe nga grafiku më sipër, pjesa më e madhe shprehet se nuk do të hiqnin dorë nga trashëgimia sikur një nga anëtarët e familjes do ti kërkonte të hiqnin dorë, rreth 49.41% e grave dhe vajzave të anketuara janë shprehur jo. Ndërkohë që rreth 24.31% janë shprehur po e 29.28% janë shprehur se nuk e dijnë. Fatkeqësisht, pavarësisht se referuar shifrave rezulton se pjesa më e madhe ka zgjedhur opsionin jo, rezulton një shifër relativisht e konsiderueshme që bindshëm konsideron heqjen dorë dhe një pjesë tjetër gjithashtu e konsiderueshme e cila shprehet “nuk e di” duke lënë të hapura mundësitë për interpretim.

Pyetja e fundit kërkon të hedhë dritë mbi mendësinë që të anketuarit kanë në lidhje me trajtimin e fëmijëve të tyre në trashëgimi. Konkretisht ato u pyeten se “pasurinë e tyre kujt do ia trashëgojnë apo trashëgonin sikur të kishin fëmijë”? Përgjigjet lidhur me këtë pyetje demonstrojnë se pjesa më e madhe konsideron trajtimin e tyre në mënyrë të barabartë duke zgjedhur opsionin “edhe djalit edhe vajzës”, ndërkohë që kemi një përqindje prej 22.54% të cilët janë të bindur se duhet t’i lihet vetëm djemve.

Interesant është fakti se nga 55 të anketuar që janë shprehur se do ja linin djemve 34 rezultojnë të jenë gra dhe vajza.



Canada

Në mënyrë të përmbledhur nga të dhënat e anketimit, mund të themi së në Bashkinë Shkodër:

gratë dhe vajzat rezultojnë të jenë të arsimuara, të punësuar në sektor publik privat dhe **kontribuese në familje me të ardhura**, paçka se këto të ardhura rezultojnë herë të ulta e herë të larta, herë fikse e herë jo fikse duke i krijuar një ndjese destabiliteti ekonomik. Gjithashtu rezulton se 28.57% e grave që i janë përgjigjur anketimit, **nuk i administrojnë vetë të ardhurat e tyre** dhe se të ardhurat administrohen nga anëtarë të familjes duke na lënë të kuptojmë që një pjese e tyre **jetojnë në varësi të plotë ekonomike nga anëtarët e tyre të familjes**.

Për sa i takon çështjeve që lidhen me të drejtat pronësore të rrjedha nga trashëgimia rezulton se në Bashkinë Shkodër pjesa më e madhe e të anketuarve është përgjigjur se kanë informacion të përgjithshëm sa i takon të drejtave të tyre të pronësisë të rrjedha nga trashëgimia, gjithashtu **janë në dijeni të barazisë ndërmjet burrit dhe gruas djemve dhe vajzave në këto çështje**.

Gjithashtu vihet re se ato kanë një perceptim të përgjithshëm se **gratë dhe vajzat në raport me burrat dhe djemt janë të disfavorizuara** në këto të drejta dhe se **më shpesh trashëgojnë burrat dhe djemt**.

Pjesa më e madhe rezulton se **nuk kanë trashëguar pasuri**, për shkak se prindërit janë ende gjallë, dhe bashkëshortët po ashtu ndërkohë që kemi një pjesë të konsiderueshme e cila është përgjigjur si më poshtë vijon:

trashëgimia pas vdekjes së prindërve i takon vëllezërve dhe vëllait” 14.29%, “ia kam dhuruar vëllait” 2% dhe “kam hequr dorë nga trashëgimia” thuhet 9%. Të dhëna të cilat dëshmojnë se **edhe në Bashkinë Shkodër si ndodh rëndom edhe në bashkitë e tjera të Shqipërisë, mendësia se trashëgimia pas vdekjes u takon vëllezërve si edhe heqja dorë nga trashëgimia janë dy fenomene të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në aksesimin e grave dhe vajzave të të drejtave pronësore që rrjedhin nga trashëgimia**.

Nga të dhënat e studimit rezulton se në përgjithësi qoftë gratë dhe vajzat qoftë djemt dhe burrat shprehen se të drejtat e trashëgimisë duhet të kërkohen nga gratë dhe vajzat edhe në familjen e origjinës edhe tek familja e bashkëshortit. Megjithatë shqetësues rezulton të jetë fakti që ekziston një shifer e konsiderueshme e cila beson se **nuk duhet ti kërkohen të drejtat e tyre të trashëgimisë qoftë në familjen e origjinës qoftë në familjen e bashkëshortëve**.

Gjithashtu rezulton se pjesa më e madhe e të anketuarve bien dakord që të drejtat trashëgimore duhet të kërkohen qoftë nga familja e origjinës qoftë nga bashkëshorti. **20% e të anketuarve që mendojnë se nuk duhet të kërkohen këto të drejta tek familja e origjinës, argumentojnë me baza mentaliteti patriarkal të tilla si, “jo sepse grate**



Canada

martohen dhe pasuria e familjes së origjinës i takon djemve të familjes”, “djali si trashëgimtar i mbiemrit siguron edhe vazhdimsinë e emrit të familjes i takon atij”, “se vajza ka marrë pajë kur është martuar”, “gruaja ka pjesën e trashëgimisë tek i shoqi”. Këtu vlen të përmendet që kjo mendësi është prezente bindshëm edhe tek gratë dhe vajzat dhe jo vetëm tek burrat dhe djemtë.

Gjithashtu vihet re se **fenomeni i heqjes dorë nga trashëgimia për shkak se i takon vëllezërve apo familjarëve të bashkëshortit rezulton të jetë prezent dhe tek gratë dhe vajzat e Bashkisë Shkodër**, rreth 24.41% e grave dhe vajzave të anketuara janë shprehur se janë gati të heqin dorë nga trashëgimia nëse një familjar do ia kërkonte.

Rezultoni se pjesa më e madhe e të anketuarve është e gatshme ti trajtojë fëmijët të barabartë në trashëgimi, rreth **22.54% janë të bindur se duhet t’i lihet vetëm djemve**.

Të dhëna nga intervistat

Gjatë tjetërsimit, fitimit dhe heqjes dorë nga pasuria e paluajtshme në përgjithësi nga ana e grave dhe vajzave, gjyqtarët, noterët, punonjësit e kadastrës juristët dhe avoketërit të cilët janë të angazhuar në organizatat e shoqërisë civile që operojnë në Shkodër dhe që kanë në fokus të veprimtarisë së tyre mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave, kanë një rëndësi të veçantë në mbrojtjen e këtyre të drejta. Pikërisht nisur nga kjo rëndësi është konsideruar si i domosdoshëm intervistimi i tyre për të vjelur të dhëna të cilat gjenerojnë nga eksperiencat e tyre në përditshmërinë profesionale, për sa i takon problematikave që gratë ndeshin në aksesimin e të drejtave të tyre trashëgimore pronësore nën prespektivën e praktikës së gjyqësorit, noterëve, punonjësve të kadastrës si dhe juristëve dhe avoketëve të angazhuar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave.

Me gjyqtarët

Janë intervistuar 5 gjyqtarë të cilët e ushtrojnë detyrën e tyre në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Këndvështrimi i tyre i bazuar në eksperiencë, pasqyron një përshlytje të përgjithshme që **ligji udhëhiqet nga parimi i mosdiskriminimit dhe barazisë ndërmjet burrave dhe grave në çështjet e pronësisë dhe trashëgimisë**, pjesa më e madhe shprehen se nuk arrijnë të evidentojnë në eksperiencën e tyre raste të diskriminimit apo të trajtimit të favorshëm të njëjës gjini përkundëjt tjetrës, dhe në dijeninë e tyre shprehen se nuk ka as ndonjë vendim gjyqësor që e bën këtë, megjithatë shprehen se **nëse ka ndonjë rast ku dedektohet diskriminim ai është çdo herë i nxitur nga bazat e kulturës, krahinës dhe zonës ku banojnë burri dhe gruaja, mentaliteti, niveli arsimor etj.** Të pyetur konkretisht në lidhje me institutin e heqjes dorë nga trashëgimia, ato e konsiderojnë këtë veprim si një veprim juridik të njëanshëm, formal, të vullnetshëm nga gjithsecili i cili behët përpara noterit, më rëndësi është që vullneti të jetë real dhe i pavesuar. Njëri nga gjyqtarët shton se në lidhje me vullnetin, noteri duhet të hulumtojë nëse vullneti ka qënë i singertë, i pandikuar i pa imponuar. Sipas mendimit të tyre **roli i gjykatës jo vetëm në zbutjen e fenomenit të**



Canada

diskriminimit në çështjet e trashëgimisë e pronësisë të grave dhe vajzave është gjithmonë dhënia e drejtësisë sipas një gjykim të drejtë, transparent, të paanshëm dhe të shpejtë, duke rritur kështu besimin në drejtësi. Ndërsa për sa i takon pyetjes lidhur me rolin që mund të ketë bindja e tyre e brëndshme në dhënien e vendimeve që lidhen me të drejtat pronësore trashëgimore të grave përgjigjet e tyre konsistojnë në evidentimin e faktit se bindja e gjyqtarit në çdo lloj dhe objekt gjykimi është në bazë të provave e argumentave pavarësisht gjinisë së palëve ndërgjyqëse. Ato janë të bindur se **adresimi i aksesimit të grave dhe vajzave në të drejtat e trashëgimisë pronësore është tejet i rëndësishëm për të ndërgjegjësuar jo vetëm gratë dhe vajzat por edhe djemt dhe burrat. Dhe së për këtë duhet të ketë angazhim akoma më konstant e persistent të organizatave të shoqërisë civile.** Në iniciativat që ato ndërmarrin duhet të adresohen me këmbëngulje barazia ndërmjet grave/vajzave dhe burrave/djemve në çështjet e pronësisë e trashëgimisë. Ndërkohë që me interes është mendimi i një gjyqtari i pyetur lidhur me ndonjë ndërhyrje që do ishte e domosdoshme për të adresuar problematiken disfavorizimit të grave dhe vajzave në çështjet e pronësisë dhe trashëgimisë shprehet se “**duhet të ti kushtohet vëmendje procedurave të kredisë bankare që kryejnë me bankat çiftet e bashkëshortëve,** pasi vihet re që zakonisht përfshihen si dorëzanëse gratë bashkëshorte dhe këtu mendoj se nuk i kanë mirë të shpjeguara pasojat e cilësisë së palës që marrin në ato veprime”. Me interes është edhe konstatimi i një tjetër gjyqtari i cili sjell në vëmendje **si rast diskriminimi frekuent, kontributin e grave dhe vajzave në shtëpinë e tyre të origjinës** “kur gruaja me lidhjen e martesës shkon të jetojë në shtëpinë e bashkëshortit të saj, por nuk merr asgjë nga kontributi që ajo kishte dhënë gjatë kohës që ka qenë në shtëpinë e babait. Kujtojmë këtu ligjin nr. 7501/1991 ‘Për token’, në bazë të të cilit toka bujqësore jepej në pronësi në bazë të numrit të personave që kishin lindur deri më datë 1 Gusht 1990. Pavarësisht se vajza ishte lindur përpara datës 1 Gusht 1990, me martesën nuk e merrte pjesën e saj takuese për shkak të ligjit të sipërcituar. Kjo ka ndodhur rëndom, sepse ekzistonte mendësia e kohës që femrat nuk marrin asgjë.”

Me noterët

Rezulton se të gjithë noterët e intervistuar (3) janë në dijeni të ndryshimeve që kanë pasur në fokus garantimin e parimit të barazisë gjinore dhe mbrotjen e grave nga diskriminimi për shkak të gjinisë. **Ato pohojnë së për zbatimin e këtyre ndryshime janë marrë masa mbasi në rast mos zbatimi i kthen kadastra pa veprime.** Në përgjithësi ato bëjnë me dije se për të evituar rastet e heqjes dorë nga trashëgimia ato i informojnë gratë dhe vajzat përpara, duke i bërë të ditur se edhe në rastet kur çifti nuk ka fëmijë, ajo mund të trashëgohet nga prindërit, motrat, vëllezërit dhe nëse ajo heq dorë i ka hequr të drejtën edhe të sipërpërmendurve për ta trashëguar. Të pyetur në lidhje me kë kondiserojnë ato, bazuar në eksperiencën e tyre, **si shkaqe bazë mbi të cilat lind dhe zhvillohet diskriminimi, ato janë të mendimit së shkak është mënyra se si e kuptojnë familjen, të drejtat e anëtarëve të familjes, sidomos në zonat rurale.** Njëra nga noteret e intervistuar lidhur me çështjen shprehet se “**në rastet e disponimeve të testamenteve në favor të djemve (më së shumti) reflektohet qëllimi i**



Canada

prindërve trashëgimlënës që të shprehin vullnetin e tyre që pasuria të trashëgohet nga djali me të cilin jetojnë, ose përkujdeset për prindërit ose ka qënë investitor për fitimin e pasurisë”. Në lidhje me pyetjen nëse ligji lë hapsira për diskriminim, të gjithë noterët e intervistuar shprehën se **ligji nuk lë hapsira për diskriminim ndërsa për rastet e heqjes dorë të trashëgimisë apo kontratave “fiktive” të dhurimit rezultoi se në përgjithësi janë raste të motrave në raport me vëllezërit, të cilat janë shkëputur prej vitesh nga trangu familjar dhe kanë konsideruar e njohur kontributin e vëllezërve për kujdesin ndaj prindërve, si një veprim i vullnetshëm, i lirë dhe jo i imponuar nga ndonjëri prej familjarëve. Si raste më frekvente të trajtimit të disfavorshëm njëri nga noterët konsideron pikërisht disponimin me testament në favor të djemve të familjes duke argumentuar se djali siguron përkujdesjen ndaj prindërve në pleqëri, apo janë djemt ato që kanë kontribuar financiarisht për ndërtim, realizim apo blerje të shtëpisë. Gjithashtu argument i shpeshtë është edhe ai se **vajza tashmë i përket një familjeje të re dhe mund të sigurojë pasuri në familjen e re që krijon me bashkëshortin.****

Me punonjësit e kadastrës Shkodër

Punonjësit e kadastrës shprehën se janë në dijeni të të gjitha dispozitave të ligjit Nr. 111/2018, “Për kadastrën” dhe specifikisht për parashikimin e nenit 45 të këtij ligj i cili sanksionon regjistrimin në emër të të dy bashkëshortëve të pronës të blerë gjatë martesës, kur subjektet i nënshtrohen regjimit të bashkësisë ligjore. Ato shprehën se e njohin dhe e zbatojnë ligjin mbi bazën e të cilit funksionojnë në përditshmërinë e tyre gjithashtu mendojnë se ndryshimet kanë qënë të duhura, sidoqoftë **janë të mendimit që rolin kryesor në këtë mes e luan noteri dhe që është shumë e rëndësishme që punonjësit e kadastrës dhe noterët duhet të kenë një qasje të unifikuar dhe të kombinuar në zbatimin e legjislacionit** për të drejtat pronësore në përgjithësi dhe të rrjedha nga trashëgimia në vecanti. Edhe sipas mendimit të zyrtarëve të kadastrës shkaqet pas diskriminimit që i bëhet grave dhe vajzave në çështjet e pronësisë në përgjithësi i gjejnë tek mendësia patriarkale e trashëguar brez pas brezi ku prona dhe trashëgimia i përket djemve. Përveç bashkërendimit të punës ndërmjet punonjësve të kadastrës dhe noterëve sipas mendimit të tyre nevojiten edhe trajnime të vazhdueshme për punonjësit e këtyre institucione në mënyrë që të lehtësohet ndërveprimi ndërmjet tyre, si dhe është e nevojshme që organizatat e shoqërisë civile të vijnë punën për sa i takon ndërgjegjesimit dhe informimit të komunitetit në lidhje me të drejtat pronësore të rrjedha nga trashëgimia të grave dhe vajzave në Bashkinë Shkodër.

Për ekspertë jurist, avokat dhe organizatat jofitimprurëse të angazhuar në adresimin e të drejtave të grave

Janë intervistuar tre jurist të angazhuar në disa organizata jofitimprurëse të cilat operojnë në zonën e Bashkisë Shkodër dhe që kanë në fokus ofrimin e shërbimeve dhe programeve të fuqizimit ndaj grave dhe vajzave. Të pyetur nëse në eksperiencën e tyre janë hasur me raste të diskriminimit gjinor në çështje të të drejtave pronësore trashëgimore, përgjigjen se në



Canada

eksperiencen e tyre janë të shpeshta rastet e konstatimit të trajtimit të pafavorfshëm të grave dhe vajzave në çështjet e trashëgimisë dhe pronësisë. Sipas tyre shumica e grave kthehen tek familja e origjinës pas divorcit sepse nuk kanë mundësi ekonomike të përballojnë jetesën më vete. Format se si manifestohet diskriminimi janë të ndryshme sidoqoftë ato vërejnë se gratë që i referohen organizatave të tyre janë në përgjithësi gra dhe vajza të cilat jetojnë në marrëdhënie abuzive për shkak të kushteve shumë të vështira ekonomike. **Pjesa më e madhe për të mos thënë të gjitha rezultojnë të mos jenë në pronësi të ndonjë pasurie të paluajtshme, një fakt i cili i vë në pozita vështirësie të atillë që të jenë të detyruara të pranojnë marrëdhëniet abuzive në të cilat ndodhen.** Sipas të intervistuarve **gratë nuk kanë shumë informacion lidhur me të drejtat e tyre pronësore e trashëgimore, ato nuk trashëgojnë nga familja e origjinës, heqin dorë nga pasuria në favor të vëllezërve.** Profesionistët shprehen se në përgjithsi roli i tyre përveçse në ofrimin e shërbimit ligjor konsiston edhe në informimin e grave në lidhje me të drejtat e tyre, dhe format se si mund ti kërkojnë ato duke i ofrar edhe suportin për asistencë përgjatë procesit. Kuptohet që organizatat e shoqërisë civile bëjnë një punë shumë të madhe për sa i takon informimit dhe ndërgjegjësimin të grave dhe vajzave në lidhje me të drejtat e tyre, megjithatë çështjes së të drejtave pronësore dhe të trashëgimisë duhet t'i jepet më shumë prioritet në kuadër të fuqizimit ekonomik të tyre. Edhe mes juristëve dhe avoketëve që punojnë me këtë target dhe kanë në fokus të drejtat e tyre, mbizotëron opinioni **që bazat mbi të cilat lind dhe zhvillohet ky diskriminim gjinden tek mentaliteti, niveli arsimimit, mungesa e informacionit.** Dhe pikërisht në këtë kuadër ato sugjerojnë që të ndërmerren sa më shumë iniciativa të përbashkëta, të ndërthuret bashkëpunimi ndërmjet instituconeve dhe shoqërisë civile në këtë kuadër me qëllim reduktimin e këtij fenomeni dhe rritjen e aksesit të grave në të drejtat e pronësisë dhe trashëgimisë.



Canada

Përfundime

Rezulton se me gjithë kuadrin ligjor relativisht të plotë sa i takon barazisë gjinore, realiteti ligjor nuk pasqyron realitetin në praktikë. Megjithëse legjislacioni vendos sanksionon të drejta të barabarta të pronës dhe trashëgimisë, gratë, de facto, rezultojnë më pak pronare sesa burrat dhe gjithashtu rezultojnë të përballen me vështirësi në aksesimin e këtyre të drejta. Vihet re që në përgjithësi ato problematika e vështirësi që hasin gratë dhe vajzat në të gjithë Shqipërinë janë të ngjashme edhe me kontekstin e Bashkisë Shkodër.

Komuniteti në Shkodër nga të dhënat e nxjerra nga hulumtimi rezulton të jetë relativisht i informuar në lidhje me të drejtat pronësore të rrjedha nga trashëgimia të grave dhe vajzave, megjithatë rezulton të ketë gjithashtu një përqindje të konsiderueshme e cila vijon të shfaqë mangësi në informacion si dhe karakteristika të mendësisë patriarkale e cila ndikon negativisht në aksesin e grave ndaj këtyre të drejta, duke ndikuar pastaj në vazhdimësi edhe në aspekte të tjera të jetës, qoftë në aspektet ekonomike e financiare qoftë në pozitën e tyre në familje.

Nga hulumtimi i realizuar në Bashkinë Shkodër konstatojmë që në përgjithësi ligji zbatohet me përpikëri dhe nuk lë hapësira për diskriminim, sidoqoftë sugjerohet të mbahet parasysh koordinimi i punës ndërmjet institucioneve sidomos noterëve dhe zyrtarëve të kadastrave për sa i takon të drejtave pronësore dhe trashëgimore të grave dhe trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve më një perspektive gjinore. Gjithashtu, çfarë vijon të nënvizohet si shkak konstant që pengon vajzat dhe gratë të aksesojnë të drejta të pronësisë dhe trashëgimisë ka të bëjë më së shumti me mendësinë e shoqërisë. Fatkeqësisht edhe në realitetin e Bashkisë Shkodër e shohim prezent fenomenin e mohimit të grave dhe vajzave nga këto të drejta por edhe “mos pranimit” të të drejtave të tyre pronësore të rrjedha nga trashëgimia për shkak të mentalitetit, traditës apo normave zakonore e kulturore me të cilat janë rritur. Shqetësues rezulton të jetë fakti se kjo mendësi fatkeqësisht është prezente qoftë tek djemt dhe burrat qoftë tek vajzat dhe gratë.

Rezulton se shumica e të intervistuarve sugjerojnë që organizatat e shoqërisë civile, duke patur parasysh rolin dhe rëndësinë që ato kanë për sa i takon punës në komunitet, ndërgjegjësimin dhe informimin të komunitetit në lidhje me çështje e kauza të ndryshme, duhet të ndërmarrin iniciativa të cilat synojnë ndërgjegjësimin dhe informimin e komunitetit lidhur me të drejtat e grave dhe të vajzave në përgjithësi por kryesisht të drejtat pronësore dhe trashëgimore duke e zbutur gradualisht këtë hendek gjinor ndërmjet burrave dhe grave në çështjet e pronësisë së rrjedha nga trashëgimia. Paralelisht konsiderojmë si shumë të rëndësishëm ofrimin e ndihmës juridike edhe nëpërmjet mjeteve elektronike në respektim të kushteve të krijuara nga pandemia Covid-19, duke rritur kështu numrin e rasteve që trajtohen nga Qendra në zonat e mbuluara nga projekti.



Canada

Bibliografia

Ligje

Kushtetuta;
Kodi i Familjes;
Ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”;
Ligji nr. 111/2018 “Për kadastrën”;
Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”;
Ligji nr. 8137, datë 31.7.1996 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr.9062 datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes”;

Intrumente ligjore ndërkombëtare

CEDAW: Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (miratuar më datë 18 dhjetor 1979);
CEDAW-OP: Protokoll i Fakultativ i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (miratuar më datë 6 tetor 1999);
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (miratuar më datë 4 nëntor 1950);

Doktrinë

Nathanaili A., (1974), E drejta e pronësisë e RPSH-së, kurs leksionesh;
Latifi Juliana, (2007), E drejta Civile, Trashigimia;
Mandro Arta, (2009), E drejta Familjare – Familja, Femijët, Martesa, Bashkëshortët;
Anastasi Aurela, Material “Të drejtat pronësore dhe ekonomike të grave dhe vajzave Legjislacioni për zgjidhjen e konflikteve me bazë gjinore për çështjet e pronësisë”;

Raporte/Publikime

Avokati i Popullit (2016-2020) Raporti Alternativ mbi Zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri;
Raporti i pestë periodik i paraqitur nga Shqipëria sipas nenit 18 të Konventës, në vitin 2020 i disponueshëm në: <https://www.ecoi.net/en/file/local/2046178/N2226977.pdf>;
Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë, Qeverisja e tokës për gratë dhe burra. (FAO 2013) Një udhëzues teknik për të mbështetur arritjen e qeverisjes së përgjegjshme të barazisë gjinore të të drejtave mbi token;
CEDAW (2016), Vëzhgime përmbyllëse mbi raportin e katërt periodik të Shqipërisë, 25 korrik 2016, CEDAW /C/ALB/CO/4;



Canada

Artikull publikuar nw Report.AL “Paligjshmëria dhe tradita iu mohojnë të drejten e pronës grave dhe vajzave në Shqipëri” e disponueshme në:

<https://www.reporter.al/2019/08/06/paligjshmeria-dhe-tradita-u-mohojne-te-drejten-e-prones-grave-dhe-vajzave-ne-shqiperi/>;

UN Women (2016) “Të drejtat pronësore të grave në Shqipëri”, botim i dytë. Komiteti i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW), Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 21 i CEDAW: Barazia në Marrëdhëniet Martesore dhe Familjare, 1994, i disponueshëm në: <https://www.refworld.org/docid/48abd52c0.html>;

Komenti i Përgjithshëm Nr. 12 I CESCR “E drejta për ushqim të përshtatshëm” (Neni 11) i disponueshëm në: <https://www.refworld.org/pdfid/4538838c11.pdf>;

Shihni MD, fjala e Ministres së Drejtësisë në Konferencën mbi të drejtat e grave <http://www.drejtesia.gov.al/newsroom/lajme/ministrja-gjonaj-bashke-per-te-drejtat-e-grave-dhe-kunder-dhunes/>.